

RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR PËRCAKTIMIN E PAGAVE, TRAJTIMEVE TË TJERA FINANCIARE DHE PËRFITIMEVE TË TË PUNËSUARVE NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS PUBLIKE, SI DHE TË PAGËS BAZË MINIMALE NË SHKALLË VENDI”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj, synon miratimin e kuadrit irregulator në lidhje me përcaktimet dhe kompetencat në fushën e pagave, të trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji hartohet në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Aktualisht kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve janë të përcaktuara në ligjin nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”. Gjatë periudhës së zbatimit të tij, nga Departamenti i Administratës Publike dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë janë evidentuar disa problematika që lidhen me:

- faktin që përcaktimet e tij nuk janë në përputhje me zhvillimet dhe ligjet e reja të miratuara ndër vite, kryesisht mbi organizimin dhe funksionimin e institucioneve të administratës publike, etj;

Relacion shpjegues për projektligjin “Për përcaktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”

- mungesën e parimeve ku duhet të mbështeten organet që kanë kompetencë për të caktuar paga, trajtime të tjera financiare dhe përfitime;
- mungesën e kompetencës për të miratuar disa lloje të tjera të trajtimeve financiare dhe përfitime për të punësuarit në administratën publike, përvçe pagave dhe shpërblimeve për rezultate në punë;
- paqartësinë e përkufizimeve në lidhje me fushën e veprimit të ligjit;
- paqartësinë e kompetencave për secilin organ;
- paqartësinë e faktit se si fillon iniciatiava për përgatitjen e projektvendimeve të Këshillit të Ministrave për të përcaktuar pagat;
- paqartësinë e institucioneve propozuese për projektaktet ligjore apo nënligjore për pagat dhe trajtime të tjera financiare;
- mungesën e kompetencës së Këshillit të Ministrave, që edhe në raste kur nuk ka iniciativa për rritle të pagave në kuadër të reformave në këtë fushë, të mund të bëhet indeksimi i pagave për shkak të indeksimit të çmimeve, etj.

Bazuar në analizën si më sipër, gjyket që ligji aktual duhet të shfuqizohet dhe të hartohet e miratohet një ligj i ri, me synimin e krijimit të një kuadri rregullator të plotë e të qartë jo vetëm për kompetencat në fushën e pagave dhe të shpërblimeve, por edhe të trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike për ta bërë administratën publike më tèrheqëse për specialistët, ekspertët dhe menaxherët më të mirë, si dhe për të stimuluar performancën, inovacionin dhe konkurrueshmërinë.

Risitë e projektligjit që propozohet janë:

- krijohet një *panoramë e qartë e fushës së veprimit të ligjit*;
- në të janë përfshirë *përkufizimet për institucionet apo njësi të tjera organizative të administratës publike*, në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e institucioneve apo ligjin e buxhetit;
- është përcaktuar qartësisht që tashmë ky ligj do të irregullojë *kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe trajtimeve vetëm për të punësuarit në administratën publike*, me përjashtim të pagës minimale në shkallë vendi e cila do të jetë e detyrueshme edhe për sektorin privat (me ligjin aktualisht në fuqi kishte përcaktim e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe trajtimeve vetëm për të punësuarit në administratën publike si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi).

- përfshihen për herë të parë parimet mbi bazën e të cilave duhet të përcaktohen pagat, trajtimet e tjera financiare dhe përfitimet, gjë që mungon në ligjin aktualisht në fuqi;
- janë qartësuar kompetencat që kanë institucionet/organet që kanë të drejtë të përcaktojnë paga, trajtime të tjera financiare dhe përfitime për të punësuarit në administratën publike, duke përcaktuar njëkohësisht edhe aktin ligjor apo nënligjor për ushtrimin e këtyre kompetencave;
- janë përcaktuар institucionet që propozojnë për Këshillin e Ministrave projektvendimet në fushën e pagave, të trajtimeve të tjera financiare dhe të përfitimeve, gjë që mungonte në ligjin aktualisht në fuqi, e që ka krijuar probleme interpretimi në këtë drejtim;
- është përcaktuar procedura se si ndërmerret iniciativa për të hartuar një projektvendim të Këshillit të Ministrave për pagat, trajtimet e tjera financiare dhe përfitimet, gjë që mungonte në ligjin aktualisht në fuqi, e që ka krijuar probleme interpretimi në këtë drejtim;
- janë shtuar kompetenca të reja, për të cilat kishte boshllék ligjor, nëpërmjet të cilave përcaktohen që të punësuai në administratën publike përvèç pagës dhe shpërblimeve, do të kenë të drejtë edhe për trajtime të tjera financiare dhe përfitimeve të tjera;
- është shtuar kompetenca e Këshillit të Ministrave për të miratuar indeksimin e pagave, sipas indeksit të çmimeve të përllogaritur nga INSTAT, gjë që mungonte në ligjin aktualisht në fuqi.

Në përfundim, nëpërmjet miratimit të këtij ligji gjykojmë që:

- krijohet një kuadër rregulator i konsoliduar për kompetencat e caktimit të pagave, të trajtimeve të tjera financiare dhe të përfitimeve të tjera të të punësuarve në administratën publike;
- të punësuarve të administratës publike u njihet e drejta edhe për trajtime të tjera financiare dhe përfitime, përvèç pagës dhe shpërblimit për rezultate në punë;
- i jepet zgjidhje nevojës për të siguruar pagesa konkurruese me tregun privat për disa kategori në fusha apo nënëfusha prioritare të zhvillimit të vendit;
- i jepet zgjidhje të gjitha problematikave të evidentuara ndër vite.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është hartuar në mbështetje të neneve 78, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon përafrimin e ndonjë *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektligji propozohet nga Këshilli i Ministrave.

Projektligji është i organizuar në 3 krerë dhe 11 nene, që propozojnë:

Kreu I – Dispozita të Përgjithshme (nenet 1 – 4)

Konkretnisht në këtë kre janë përcaktuar:

- ✓ *Qëllimi i ligjit*, që, siç e cituam edhe më sipër në këtë relacion, është krijimi i kuadrit rregullator mbi kompetencat në fushën e pagave, të trajtimeve të tjera financiare dhe të përfitimeve të tjera të të punësuarve në institucionet e administratës publike.
- ✓ *Objekti i ligjit* – përcaktimi i organeve që kanë të drejtë të propozojnë dhe miratojnë: (i) paga, trajtime të tjera financiare dhe përfitime për të punësuarit e institacioneve të administratës publike; (ii) pagën bazë minimale në shkallë vendi, të detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo punëdhënës në Republikën e Shqipërisë.
- ✓ *Përkufizimet e termave* që përdoren në ligj, me synimin e qartësimit të fushës së tij të veprimit, e konkretisht:
 - (i) me institacione të administratës publike do të kuptohen institucionet e administratës shtetërore, forcat e armatosura, përfaqësítë, institucionet e pavarura, njësitë e vetëqeverisjes vendore, njësitë e fondeve speciale dhe ndërmarrjet shtetërore me kapital mbi 50 për qind shtetëror;

Relacion shpjegues për projektligjin “Për përcaktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”

- (ii) me institucionet e administratës shtetërore do të kuptohen Kryeministria, ministritë, institucionet në varësi të Kryeministrit apo ministrave, njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve, agjencitë autonome dhe administrata e prefektit;
- (iii) me institucionet e pavarura kuptohen institucionet e pavarura të parashikuara në Kushtetutë apo të krijuara me ligj dhe që i raportojnë Kuvendit, përfshirë degët e tyre territoriale;
- (iv) me “njësi të vetëqeverisjes vendore”, do të kuptohen të njëjtat organe/institucionet sipas përcaktimit të ligjit për vetëqeverisjen vendore;
- (v) me njësi të fondeve speciale do të kuptohen të njëjtat institucionet/ente sipas përcaktimit të ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë;
- (vi) me termin “trajtime të tjera financiare” do të kuptohen shpërblimi për rezultate në punë apo inovacionet sipas sektorëve, mbështetja financiare e menjëherëshme, shtesa e veçantë e kushtëzuar e pagës mbi pagën bruto mujore, çmimet/shpërblimet për ide inovative dhe inovacion, çmimet/shpërblimet për projekte të fituara nga të cilat janë përthithur fonde dhe/ose ka përfituar institucioni/vendi (sqarojmë se në ligjin aktualisht në fuqi njihej vetëm shpërblimi për rezultate në punë);
- (vii) me “përfitime” do të kuptohen shërbimet e veçanta, trajtime të veçantë për nëpunësin/punonjësin dhe/ose fëmijët/familjen e tij, trajnimet, aftësimi, riaftësimi dhe edukimi gjatë gjithë jetës;
- (viii) me “sektor publik” do të kuptohen institucionet e administratës publike dhe institucionet/entet publike që sipas legjisacionit të tyre specifik janë krijuar si të tilla.
- ✓ *Fusha e veprimit e ligjit –* në fushën e veprimit të këtij ligji do të përfshihen funksionarët e zgjedhur apo të emëruar, nëpunësit civilë, nëpunësit dhe punonjësit e tjerë në institucionet e administratës publike. Gjithashtu, paravësish se ligji do të zbatohet për institucionet e administratës publike, ai përjashtimit për: (i) efekt të përcaktimit të pagës minimale në shkallë vendi, do të jetë i detyrueshëm për zbatim edhe për sektorin privat (siç është e përcaktuar edhe në ligjin aktualisht në fuqi); (ii) përfitimeve për përcaktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve, do të jetë i detyrueshëm për zbatim edhe për institucionet/ente të tjera të sektorit publike që nuk përfshihen në fushën e veprimit të ligjit.

Relacion shpjegues për projektligjin “Për përcaktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”

- ✓ *Parimet për përcaktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve.*
Për herë të parë në këtë projektligj propozohen të përfshihen parimet ku duhet të mbështeten organet që kanë kompetencë për të përcaktuar paga, trajtime të tjera financiare dhe përfitime për të punësuarit e administratës publike. Në përcaktimin e tyre organet që e kanë këtë kompetencë duhet të garantojnë shpërblimin e drejtë dhe dinjitoz të të punësuarve me qëllim që institucionet e administratës publike të jenë në gjendje të marrin në punë të punësuar të motivuar dhe që përbushin me shpejtësi dhe cilësi funksionet e tyre; të motivojnë të punësuarit nëpërmjet skemave të posaçme që të rrisin performancën në punë; të sigurojnë një shpërblim të drejtë dhe të barabartë për punë të njëjtë; të krijohet një sistem pagash dhe shpërblimesh që mund t'i përgjigjet nevojës për të përbushur prioritetet; të jenë në gjendje të konkurojnë me sektorin privat, për punësimin e punonjësve të talentuar.

Kreu II - Kompetencat për caktimin e pagave, të trajtimeve të tjera financiare dhe të përfitimeve (nenet 5 – 9)

Konkretnisht në këtë kre janë përcaktuar:

- ✓ Cilat janë **organet** që duhet të kenë kompetencë për të përcaktuar paga, trajtime të tjera financiare dhe përfitime për të punësuarit e institucioneve të administratës publike, konkretisht: Kuvendi; Këshilli i Ministrave; këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore (këshillat bashkiakë dhe këshillat e qarqeve); organet kolegjiale drejtuese të njësive të fondeve speciale; organet kolegjiale drejtuese të ndërmarrjeve shtetërore me kapital mbi 50 për qind shtetëror; organet kolegjiale drejtuese të institucioneve të pavarura apo të institucioneve të administratës shtetërore, në rastet kur këto institucione financohen pjesërisht apo tërësisht nga fonde të tjera të ndryshme nga ato të buxhetit të shtetit dhe kur kjo kompetencë është përcaktuar shprehimisht në ligjin e krijimit dhe organizimit e funksionimit të tyre.
- ✓ **Kompetencat e Kuvendit**, për të miratuar me ligj pagën e Presidentit, në kuadër të miratimit të ligjit të buxhetit; raportet e pagave për Kryeministrin, deputetët, ministrat, dhe titullarët e anëtarët e organeve kolegjiale drejtuese të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj; elementët përbërës të pagës bruto mujore (pra strukturën e pagës) për të

punësuarit, me përjashtim të të punësuarve në njësitë e fondeve speciale dhe në ndërmarrjet shtetërore me kapital mbi 50 për qind shtetëror.

Përveç këtyre kompetencave që Kuvendi i ka edhe në ligjin aktual në fuqi, është përcaktuar edhe kompetenca për të miratuar vlerën e çdo elementi të pagës bruto mujore për titullarët e institucioneve të pavarura kushtetuese, në kuadër të miratimit të ligjit të krijimit, organizimit dhe funksionimit të institucionit përkatës. Sqarojmë se kjo kompetencë, pavarësisht se është ushtruar gjatë këtyre viteve, nuk ka qenë e përfshirë shprehimi i ligjin nr. 10405/2011. Nëpërmjet shtimit të kësaj kompetence realizohet edhe harmonizimi i këtij ligji, me ligje të tjera në fuqi për institucionet e pavarura kushtetuese në të cilat janë përcaktuar përveç elementeve të pagës edhe vlerat për secilin element.

✓ **Kompetencat e Këshillit të Ministrave**, për të miratuar me vendim;

(i) *Me propozim të ministrit përgjegjës për çështjet e punësimit*, pagën minimale mujore, në shkallë vendi, e cila është e detyrueshme të zbatohet nga çdo punëdhënës në Republikën e Shqipërisë. Në krahasim me ligjin aktual është hequr emërtimi i saktë i ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale dhe është përdorur shprehja e përgjithshme “ministri përgjegjës për punësimin”, për shkak se kompozimi i Këshillit të Ministrave (si organ kolegjial) ndryshon varësisht vizionit politik të forcës politike. Gjithashtu, për shkak se paga minimale në shkallë vendi ndikon edhe në përcaktimin e pagave të të punësuarve të tjera të administratës publike, por edhe në trajtime të tjera financiare, në projektligj propozohet për herë të parë që gjatë procesit të hartimit të projektvendimit nga ministria përgjegjës për çështjet e punësimit, ai të bashkërendohet edhe me institucione të tjera që kanë kompetencë për të përgatitur projektvendime të Këshillit të Ministrave për pagat apo trajimet e tjera financiare, konkretisht Departamentin e Administratës Publike dhe ministrinë përgjegjëse për financat.

(ii) *Me propozim të Zëvendëskryeministrit apo ministrit nën përgjegjësinë e të cilit është DAP-i (kur ky i fundit është nënë përgjegjësinë e një ministri):*

- Elementët përbërës të pagës bruto mujore dhe vlerën për çdo element të pagës bruto mujore për të punësuarit e institucioneve të administratës publike për të cilët këto elemente nuk janë shprehur në ligjet e posaçme. Në krahasim me ligjin aktual në fuqi, në këtë projektligj propozohet që Këshilli i Ministrave të mos e ketë këtë kompetencë për: (i) njësitë e fondeve

speciale dhe ndërmarrjet shtetërore me kapital mbi 50% shtetëror, pasi kompetenca propozohet t'i jepet organeve kolegiale të tyre; (ii) institucionet e pavarura dhe institucionet e administratës shtetërore në rastet kur këto institacione financohen pjesërisht apo tërësisht nga fonde të tjera të ndryshme nga ato të buxhetit të shtetit, kur kjo kompetencë i është dhënë shprehimisht në ligjin e krijimit dhe organizimit e funksionimit të tyre, organeve kolegiale drejtuese të tyre.

- Masën e indeksimit të pagave të të punësuarve të institucioneve të administratës publike, jo më vonë se dy vite nga indeksimi i fundit, në bazë të ndryshimit të indeksit të çmimeve të konsumit të viti apo viteve paraardhëse të përllogaritur nga INSTAT, si dhe rregullat për zbatimin e tij. Sqarojmë se kjo është një kompetencë e re e cila nuk ka qenë e përfshirë në ligjin aktualisht në fuqi. Nëpërmjet këtij parashikimi njihet detyrimi që të punësuarve të administratës publike, t'u njihet e drejta për të indeksuar pagat e tyre, bazuar në indeksin e çmimeve. Kjo kompetencë i është dhënë vetëm Këshillit të Ministrave, për të gjithë të punësuarit e institucioneve të administratës publike, pjesë e fushës së veprimit të këtij ligji.
- Rregullat, kriteret dhe masën për trajtime të tjera financiare dhe përfitime, si dhe rregullat për pagesën shtesë për punën e kryer mbi kohën normale të punës, në ditët e festave zyrtare e të pushimit javor dhe për raste të tjera, të parashikuara në Kodin e Punës dhe në ligje të tjera të veçanta, me përjashtim të të punësuarve për të cilët kjo kompetencë i është dhënë një organi tjetër, sipas përcaktimit në këtë ligj apo në ligje të tjera. Në krahasim me ligjin aktual në fuqi, në riformulimin e kësaj kompetencë parashikohet e drejta për trajtime të tjera financiare dhe përfitime të tjera.
- **Klasifikimin e funksioneve**, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe kufijtë maksimalë e minimalë të pagave për funksionarët e zgjedhur, të emëruar dhe të punësuarit e tjërë në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Kjo është një kompetencë që ezksiton si e tillë edhe në ligjin aktualisht në fuqi.
- Shtesën e veçantë të kushtëzuar mbi pagën bruto mujore, sipas fushave dhe/ose nënfushave prioritare të zhvillimit të vendit, në masën që nuk tejkalon vlerën e pagës mesatare mujore të sektorit respektiv në vendet e Bashkimit Evropain, por në çdo rast nuk mund të tejkalojë pagën mesatare mujore më të lartë të një prej vendeve të BE-së, referuar të dhënavë të

Eurostat (aktualisht, sipas të dhënave të Eurostat për vitin 2021 ajo është 6021 euro). Kjo është një kompetencë e re, që nuk ka ekzistuar në ligjin aktual. Nëpërmjet këtij parashikimi të punësuarve të administratës publike në fusha apo nënëfusha prioritare që do të përcaktohen rast pas rasti me vendim të Këshillit të Ministrave, u njihet e drejta që përveç pagës mujore të përfitojnë edhe një shtesë të kushtëzuar (psh. në kohë dhe sipas funksioneve). Kjo iniciativë, besojmë se do të krijonte kushtet e nevojshme që institucionet e administratës publike të mund të mbajnë apo të tërheqin disa kategori të punësuarish "Hightech dhe Highskilled", duke konkurruar denjesisht me tregun privat.

- Listën e fushave dhe/ose nënëfushave prioritare të zhvillimit të vendit, si dhe pozicionet/funksionet që do të përfitojnë shtesën e veçantë të kufizuar.
- Kriteret, procedurat dhe institucionet kompetente për lidhjen e marrëveshjeve me entitete të treta që i mundësojnë punonjësve të administratës publike shërbime dhe tarifa preferenciale. Edhe kjo është një kompetencë e re e shtuar që nuk ekziston në ligjin aktualisht në fuqi.

Gjithashtu, në projektligj propozohet për herë të parë që:

- Gjatë procesit të përgatitjes së projektvendimeve si më sipër, ato të bashkërendohen për efektet financiare me ministrinë përgjegjëse për financat.
- Projektvendimet e Këshillit të Ministrave si më sipër, do të vlerësohen dhe përgatiten nga Departamenti i Administratës Publike: (i) kryesisht, në rastin e rritjeve apo reformës së përgjithshme të pagave, bazuar në disponueshmërinë e fondeve përkatëse të vëna në dispozicion nga ana e ministrisë përgjegjëse për financat; (ii) pas kërkesës së Kryeministrit; (iii) pas kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, në rastin e ndryshimeve për Kryeministrinë apo ndryshimeve dhe krijimit të institacioneve në varësi të Kryeministrit; (iv) pas kërkesës së ministrave të linjës në rastin e ministritëve të linjës apo ndryshimeve dhe krijimit të institacioneve në varësi të ministrave të linjës; (v) pas kërkesës të titullarëve të institacioneve të pavarura apo organeve drejtuese të njësive të vetëqeverisjes vendore.

(iii) *Me propozimin e ministrit përgjegjës për financat:*

Relacion shpjegues për projektligin "Për përcaktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përsfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi"

- Shpérblimin e anëtarëve të këshillave, të bordeve ose të çdo organi tjetër kolegjial të institucioneve të administratës shtetërore, kur legjislacioni përkatës parashikon krijimin e një këshilli/bordi drejtues apo organi kolegjial me të drejtë pagese në këto institucione, me përjashtim të atyre shoqërive aksionere/tregëtare apo të institucioneve të tjera, rregullimi i të cilave bëhet me ligje të veçanta. Kjo është një kompetencë që ekziston edhe në ligjin aktualisht në fuqi.
- Masën e mbështetjes financiare të menjëherëshme në rastet e situatave të vështira ekonomiko – shoqërore apo situata të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, për të punësuarit në institucionet e administratës publike, me përjashtim të të punësuarve të njësive të vetëqeverisjes vendore. Kjo është një kompetencë e re e përfshirë për herë të parë në projektligji.

(iv) *Me propozimin e ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për ekonominë* – kufirin maksimal të pagës dhe të shpérblimit të titullarit të njësive të fondeve speciale, të ndërmarrjeve shtetërore me kapital mbi 50% shtetëror, si dhe kufirin e shpérblimit të anëtarëve të këshillave a të bordeve drejtuese të tyre. Kjo është një kompetencë që ekziston edhe në ligjin aktualisht në fuqi.

Gjithashtu, në projektligj propozohet që gjatë procesit të përgatitjes së projektvendimeve të Këshillit të Ministrave nga ministria përgjegjëse për financat dhe ministria përgjegjëse për ekonominë, ato të bashkërendohen me DAP-in.

✓ Kompetencat e këshillave të njësive të vetëqeverisjes vendore për të miratuar:

- vlerën e pagës për çdo funksion të zgjedhur, të emëruar, dhe për çdo të punësuar tjetër, brenda kufijve të pagave për çdo grup të njësive të vetëqeverisjes vendore, të miratuara nga Këshilli i Ministrave;
- njehsimin në pagë, në përpunhje me klasifikimin e funksioneve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, për çdo funksion të ri që vendos të krijojë;
- shpérblimin mujor të këshilltarëve dhe të kryetarëve të fshatrave, në masën deri në 10 për qind të pagës mujore të kryetarit të këshillit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore;
- shpérblime të personave, nga burimet e veta financiare, të cilët caktohen në komitete, borde, këshilla, komisione, e të tjera të kësaj natyre, që ngrihen me vendim të këshillit përkatës;

- pagat e punonjësve të njësive ekonomike dhe të institucioneve të varësisë së tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me përashtim të rasteve kur me ligj të veçantë është parashikuar ndryshe;
- masën e mbështetjes financiare të menjëherëshme në rastet e situatave të vështira ekonomiko – shoqërore apo situata të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, për të punësuarit e tyre. Kjo është një kompetencë e re e përfshirë për herë të parë në projektligj.

✓ *Kompetencat e organeve kolegiale* për të miratuar:

(i) *Organet kolegiale drejtuese të njësive të fondeve speciale dhe organet kolegiale drejtuese të ndërmarrjeve shtetërore me kapital mbi 50 për qind shtetëror:*

- elementët përbërës të pagës bruto mujore të të punësuarve të tyre, që është një kompetencë e re e propozuar në këtë projektligj;
- vlerën për çdo element të pagës bruto mujore të të punësuarve të tyre, duke respektuar kufirin maksimal të caktuar nga Këshilli i Ministrave, në varësi të mundësive të tyre financiare dhe pas miratimit nga Kryeministri apo ministri nën përgjegjësinë e të cilit janë, që është një kompetencë ekzistuese;
- masën e shpërblimit për rezultate në punë, por jo më shumë se një pagë mujore në vit, pas daljes së rezultatit finansiar vjetor, si dhe pas miratimit nga Kryeministri apo ministri përkatës nën përgjegjësinë e të cilit janë, që është një kompetencë ekzistuese.

Gjithashtu, në projektligj vijon të ruhet kufizimi, që për ndërmarrjet shtetërore, veprimtaria e të cilave është me humbje, ose që subvencionohen nga shteti, Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përkatës dhe të ministrit përgjegjës për financat, të miratojë, me akte të veçanta, nivelin e pagave dhe të shpërblimeve të të punësuarve të tyre.

(ii) *Organet kolegiale drejtuese të institucioneve të pavarura apo të institucioneve të administratës shtetërore, në rastet kur këto institucionë financohen pjesërisht apo tërësisht nga fonde të tjera të ndryshme nga ato të buxhetit të shtetit dhe kur kjo kompetencë është përcaktuar shprehimisht në ligjin e krijimit dhe organizimit e funksionimit të tyre, në rastet kur kur nuk ka përcaktimë në ligjin e tyre specifik:*

- elementët përbërës të pagës bruto mujore të të punësuarve të tyre;
- vlerën për çdo element të pagës bruto mujore të të punësuarve të tyre;
- rregullat, kriteret dhe masën e trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimet.

Ky është një parashikim i ri i përfshirë për herë të parë në këtë projektligj.

- pagat e punonjësve të njësive ekonomike dhe të institucioneve të varësisë së tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me përashtim të rasteve kur me ligj të veçantë është parashikuar ndryshe;
- masën e mbështetjes financiare të menjëherëshme në rastet e situatave të vështira ekonomiko – shoqërore apo situata të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, për të punësuarit e tyre. Kjo është një kompetencë e re e përfshirë për herë të parë në projektligj.

✓ *Kompetencat e organeve kolegiale* për të miratuar:

(i) *Organet kolegiale drejtuese të njësive të fondeve speciale* dhe *organet kolegiale drejtuese të ndërmarrjeve shtetërore me kapital mbi 50 përqind shtetëror:*

- elementët përbërës të pagës bruto mujore të të punësuarve të tyre, që është një kompetencë e re e propozuar në këtë projektligj;
- vlerën për çdo element të pagës bruto mujore të të punësuarve të tyre, duke respektuar kufrin maksimal të caktuar nga Këshilli i Ministrave, në varësi të mundësive të tyre financiare dhe pas miratimit nga Kryeministri apo ministri nën përgjegjësinë e të cilët janë, që është një kompetencë ekzistuese;
- masën e shpërbimit për rezultate në punë, por jo më shumë se një pagë mujore në vit, pas daljes së rezultatit financiar vjetor, si dhe pas miratimit nga Kryeministri apo ministri përkatës nën përgjegjësinë e të cilët janë, që është një kompetencë ekzistuese.

Gjithashtu, në projektligj vijon të ruhet kufizimi, që për ndërmarrjet shtetërore, veprimtaria e të cilave është me humbje, ose që subvencionohen nga shteti, Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përkatës dhe të ministrit përgjegjës për financat, të miratojë, me akte të veçanta, nivelin e pagave dhe të shpërblimeve të të punësuarve të tyre.

(ii) *Organet kolegiale drejtuese të institucioneve të pavarura apo të institucioneve të administratës shtetërore, në rastet kur këto institucione financohen pjesërisht apo tërësisht nga fonde të tjera të ndryshme nga ato të buxhetit të shtetit dhe kur kjo kompetencë është përcaktuar shprehimisht në ligjin e krijimit dhe organizimit e funksionimit të tyre, në rastet kur kur nuk ka përcaktime në ligjin e tyre specifik:*

- elementët përbërës të pagës bruto mujore të të punësuarve të tyre;
- vlerën për çdo element të pagës bruto mujore të të punësuarve të tyre;
- rregullat, kriteret dhe masën e trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimet.

Ky është një parashikim i ri i përfshirë për herë të parë në këtë projektligj.

Kreu III – Dispozita të fundit (nenet 10 – 11)

Në këtë kre propozohet shfuqizimi i ligjit aktualisht në fuqi dhe hyrja në fuqi e tij.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucionet e ngarkuara për zbatimin e ligjit janë institucionet e administratës publike, pjesë e fushës së tij të veprimit.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga grupei i punës me përbërje të përfaqësuesve nga kabinetin i Zëvendëskryeministrit, Departamentit të Administratës Publike dhe ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETOKE

Ky projektligj nuk implikon efeket financiare, pasi në të janë përcaktuar parimet për përcaktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të tjera për të punësuarit e administratës publike, organet që kanë kompetencë për caktimin e tyre, si dhe kompetencat e secilit organ.

Relacion shpjegues për projektligjin “Për përcaktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”